



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 26.

Prishtinë, më 9.11.2015, në orën 13:00.

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303.

PROCESVERBAL

i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Lirije Kajtazi, Salihe Mustafa, Slavko Simiq, Etem Arifi dhe Kujtim Paçaku.

Munguan: Mexhide Mjaku-Topalli, Mytaher Haskuka, Teuta Haxhiu dhe Valdete Bajrami.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Sulltane Gashi, zyrtare e fushës dhe Burim Tahiri-UNICEF.

Pjesëmarrës të tjerë: Osman Shatri-HANDIKOS, Dalina Kërçeli-YIHR, Ukë Gashi-ZPRK, Nora Kelmendi-KDI, Artan Mulliqi-RTK, Beadin Sylja-Kosova Press, Albulena Nuha-RTV 21, Afrim Maliqi-HANDIKOS, Mejreme Tahirukaj-Radio Kosova dhe Amire Qamili-BIRN.

Mbledhjen e kryesoi, Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nr.25;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë;
4. Miratimi i Udhëzuesit për shqyrtimin e Peticioneve;

5. Të ndryshme.

Kryetarja, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua me heqjen e pikës 4 nga rendi i ditës, pasi që znj. Mexhide Mjaku - Topalli, që ishte kryesuese e Grupit Punues për udhëzuesin për shqyrtimin e peticioneve nuk ishte e pranishme në takim.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr. 25;

Kryetarja-konstatoi se procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 29.10.2015, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë;

Kryetarja, pasi përshëndeti përfaqësuesit e personave me aftësi të kufizuar, i njoftoi të pranishmit se projektligji për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë, i ka arritur Komisionit i kompletuar me gjithë dokumentacionin e nevojshëm, duke e përfshirë edhe Raportin preliminar të Zyrës për Harmonizim dhe Standardizim. Ajo në vazhdim i ftoi për debat anëtarët e tjerë të komisionit, para se ta vendosin për miratim në parim projektligjin në fjalë.

Salihe Mustafa, e ritheksoi mendimin nga mbledhja e kaluar, pasi që ajo kishte kërkuar që projektligji të miratohet në parim mbledhjen e kaluar për shkak të ndjeshmërisë së tij, mirëpo, prapë shprehi gatishmërinë e saj për ta votuar në parim këtë projektligj, i cili rregullon statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Lidhur me përmbajtjen e projektligjit, ajo tha se ka disa vërejtje, të cilat janë të nevojshme të ndryshohen, mirëpo, këto veprime do të ndërmerren nga Komisioni në bashkëpunim me shoqata si dhe me Qeverinë, pasi që projektligji të miratohet në parim nga Kuvendi.

Po ashtu, ajo i kushtoi kujdes të veçantë harmonizimit të këtij projektligji me ligjet e tjera që janë në fuqi, duke e precizuar lirimin nga premiumet, pasi që jenë konsultuar me ligjet aktuale. Sa i përket funksionimit të komisionit për vlerësimin e personave me aftësi të

kufizuar, ajo tha se është e nevojshme të identifikohet se a është komisioni i njëjtë, apo ka nevojë që të formohet Komision i veçantë për këtë kategori?

Ajo në fund tha se e përkrah miratimin e rekomandimit për miratim në parim të këtij projektligji.

Kujtim Paçaku, theksoi se edhe në të kaluarën ka kërkuar që të trajtohet me kujdes të veçantë kjo kategori e personave të cilët meritojnë beneficione edhe më të larta se sa që i kanë kërkuar në ligj. Ai tha se duhet të trajtohen me kujdes kërkesat e tyre. Paçaku, po ashtu i kushtoi vëmendje çështjes së punësimit të këtyre personave, duke i përfshirë edhe organet vendimmarrëse, duke përmendur përcaktimin ligjor që çdo i 50 punëtorë duhet të jetë person me aftësi të kufizuar. Ai shprehi mendimin e tij pro miratimit të rekomandimit për miratim në parim të këtij projektligji.

Kryetarja duke analizuar përmbajtjen e këtij projektligji, thekso se janë gjithsej 26 nene, duke përfshirë të gjithë materien, por disa çështje po ashtu mbesin të rregullohen edhe me akte nënligjore brenda afatit të përcaktuar me ligj. Ajo i njoftoi anëtarët e Komisionit se forumi kosovar për personat me aftësi të kufizuar, i ka dhënë mbështetje këtij projektligji, mirëpo, duhet të pasur kujdes edhe tek ligji gjithëpërfshirës sepse është me rëndësi që ti kushtohet vëmendje të gjitha fushave që prekin personat me aftësi të kufizuar.

Afrim Maliqi, në cilësinë e grupeve të interesit që i prek ky projektligj i falënderoi anëtarët e Komisionit, duke theksuar se ky projektligj ka të bëjë me kompensimin për mbështetjen e shërbimeve të domosdoshme, pasi që ky grup i personave me aftësi të kufizuar llogaritet grupi me i rrezikuar i personave me aftësi të kufizuar.

Ai në vazhdim përmendi vështirësitë me të cilat përballen përcjellësit e këtyre personave, duke shpresuar që me anë të këtij ligji do të rregullohet çështja e mbështetjes së përcjellësve të këtyre personave me aftësi të kufizuar. Ai po ashtu tha se është me rëndësi të hapet një rrugë për një ligj gjithëpërfshirës, në mënyrë që të identifikohen të gjithë personat me aftësi të kufizuar në Republikën e Kosovës.

Salihe Mustafa theksoi se si Komision, pasi që ky projektligj të miratohet në parim, do të analizojnë nen për nen, në mënyrë që të rregullohet sa më mirë. Ajo po ashtu përmendi rregullimin e ofrimit të shërbimeve shëndetësore në shtëpi falas dhe varësisht nga mundësitë buxhetore, të shikohet mundësia e rritjes së shumës mbi 50 euro, pasi që kjo shumë sipas saj është e ulët dhe nuk mjafton.

Kryetarja, pas këtyre diskutimeve i ftoi për miratimin e rekomandimit, për miratim në parim të projektligjit për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Me votim unanimit të anëtarëve, Komisioni miratoi këtë:

REKOMANDIM

Kuvendi të miratoj në parim, Projektligjin për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë

4. Të ndryshme.

Kryetarja i njoftoi anëtarët e Komisioni se Avokati i Popullit organizon një tryezë rreth bashkëpunimit të IAP-së dhe njësiveve për të drejtat e njeriut në nivelet lokale. Ky takim mbahet më 11.11. 2015, në orën 10:00, në Hotelin Sirius.

Ajo, po ashtu tha se mund të marrin pjesë të gjithë anëtarët e Komisionit, në mënyrë të identifikimit të çështjeve me rëndësi që do të trajtohen në këtë takim.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Lirije Kajtazi